

Vendim nr. 250 datë 28.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahim, i,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 28.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 16 (D) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: DASHMIRA ZARO

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për shkak të shkeljes nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë të afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes nr. 21234-02321, datë 17.11.2022.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/1, shkronja "f" dhe 134/1 shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Dashmira Zaro, në datën 24.04.2023, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me kërkesë, me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt

ligjor si rezultat i mosgjykimit nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë të çështjes së saj nr. 21234-02321, datë 17.11.2022 dhe konstatimin e mungesës së një mjeti ligjor efektiv për përshpejtimin e gjykimit. Gjykata, me vendimin nr. 44, datë 26.09.2023, (*vendimi nr. 44/2023*), ka vendosur të pranojë kërkesën, duke konstatuar shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të mungesës së efektivitetit të mjetit kompensues.

2. Në datën 08.07.2024 Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm ka marrë në shqyrtim çështjen e kërkueses dhe ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, detyrimin e palëve të paditura, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave, të paguajnë në favor të saj dëmshpërblimin prej 150,000 lekësh. Po në këtë datë, kërkuësja, nëpërmjet *e-mail*-it drejtuar Gjykatës së Lartë, ka kërkuar ti përcillet dispozitivi i vendimit të çështjes dhe gjykata, në datën 09.07.2024, nëpërmjet *e-mail*-it, i ka përcjellë kërkueses informacionin e kërkuar.

3. Vendimi i arsyetuar është vënë në dispozicion të kërkueses në datën 23.09.2024, Ministrisë së Drejtësisë në datën 20.09.2024 dhe Ministrisë së Financave në datën 19.09.2024.

4. Në datën 14.08.2024 kërkuësja ka paraqitur ankim kushtetues individual me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për shkak të shkeljes nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë të afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes nr. 21234-02321, datë 17.11.2022. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjeve nga Gjykata, i parashikuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr.8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore të anëtarëve të Gjykatës, e parashikuar në nenin 18, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000.

II

Pretendimet e kërkueses

5. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të *së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi në datën 26.09.2023 Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës së saj për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë të çështjes së saj, ndërsa shqyrtimi i çështjes në atë gjykatë ka përfunduar në datën 08.07.2024 dhe ende nuk është zbardhur vendimi i plotë, duke pamundësuar në këtë mënyrë zbatimin e menjëhershëm të këtij vendimi.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

6. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Individidi, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, pra mjafton mosplotësimi i njërit prej këtyre kriterëve që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues.

7. Kolegji vëren se në datën 24.04.2023 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjyqimit nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë të çështjes së saj nr. 21234-02321-30-2022, datë 17.11.2022, si dhe konstatimin e mungesës së një mjeti ligjor efektiv për përshpejtimin e gjyqimit. Gjykata, me vendimin nr. 44/2023, ka vendosur pranimin e kësaj kërkesë, duke konstatuar shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të mungesës së efektivitetit të mjetit kompensues.

8. Në vijim, gjykata e apelit, në datën 08.07.2024, ka shqyrtuar çështjen e kërkueses dhe ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, detyrimin e palëve të paditura, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave, të dëmshpërblejnë kërkuesen në masën 150,000 lekë.

9. Kolegji vëren, po kështu, se kërkuësja në datën 19.08.2024 i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke ngritur sërish pretendime për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjyqimit nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë të çështjes së saj nr. 21234-02321, datë 17.11.2022, por këtë herë me pretendimin se ajo nuk është shqyrtuar brenda afatit dhe se nga gjykata e apelit ende nuk është dhënë vendimi i arsyetuar.

10. Në lidhje me sa më sipër, Kolegji vëren se për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjyqimit nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të

Përgjithshëm Tiranë të çështjes nr. 21234-02321, datë 17.11.2022, Gjykata, pasi ka marrë në shqyrtim në themel kërkesën dhe shkaqet mbi të cilat bazohej ajo, u ka dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të kërkueses nëpërmjet vendimit nr. 44/2023, me të cilin është pranuar kërkesa e saj, pa përcaktuar nga ana e saj një afat konkret kohor për shqyrtimin e çështjes së saj nga gjykata e apelit. Po kështu, me vendimin e datës 08.07.2024, gjykata e apelit, pasi ka shqyrtuar çështjen, ka përfunduar gjykimin, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit. Nga informacioni zyrtar i marrë nga gjykata e apelit, për nevoja të shqyrtimit paraprak të çështjes, Kolegji vëren se vendimi i arsyetuar i asaj gjykate është bërë i disponueshëm për palët e paditura në datat 19.09.2024 dhe 20.09.2024, ndërsa për kërkuesen në datën 23.09.2024.

11. Kolegji vëren, gjithashtu, se në vendimin nr. 44/2023 Gjykata ka konstatuar shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të mungesës së efektivitetit të mjetit kompensues, nëpërmjet së cilës synohet rivendosja sa më shpejt e së drejtës së shkelur përmes përshpejtimit të procesit në gjykatën e apelit. Ndërkohë, që në momentin e paraqitjes për herë të dytë nga kërkuësja të ankimit kushtetues individual, çështja rezulton se kishte përfunduar së gjykuari edhe nga gjykata e apelit. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se mjeti procedural i përdorur nga kërkuësja, përmes ankimit kushtetues individual të parë, e ka arritur qëllimin e tij në drejtim të përshpejtimit të shqyrtimit nga gjykata e apelit të çështjes së kërkueses, me objekt detyrimin e palëve të paditura, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave, për dëmshpërblimin e saj në shumën 150,000 lekë. Po kështu, edhe sipas nenit 511 të Kodit të Procedurës Civile, vendimi bëhet i ekzekutueshëm, pavarësisht nëse ai i është vënë ose jo në dispozicion të palëve i arsyetuar.

12. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kohëzgjatja e gjyimit të çështjes së kërkueses nga gjykata e apelit në situatën që Gjykata nuk kishte përcaktuar afat për gjykimin e saj, por edhe në kushtet kur asaj tashmë i është vënë në dispozicion vendimi i arsyetuar, nuk është argument i mjaftueshëm në aspektin kushtetues për t'iu drejtuar Gjykatës, pasi ajo nuk ka arritur të provojë pasojat e ardhura për këtë shkak, për sa kohë që me vendimin e gjykatës së apelit është vendosur lënia në fuqi e vendimit të gjykatës së rrethit, fakt i cili nuk e pengon kërkuesen në të drejtën e saj për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, siç është shprehur edhe Mbledhja e Gjyqtarëve (*shih vendimin nr. 175, datë 25.07.2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

13. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkuësja nuk legjitimohet *ratione personae*, pasi nuk ndodhemi përpara një shkeljeje të tillë substanciale që do të cenonte të drejtat e saj themelore, për më tepër kërkuësja nuk ka provuar në aspektin kushtetues se në çfarë mënyre ajo është viktimë e kësaj shkeljeje, duke mos justifikuar në këtë mënyrë interesin e saj të drejtpërdrejtë, në kuptim të nenit 134, pika 2, të Kushtetutës.

14. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk përmbush kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.